



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike  
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

## **PLANI I TRAJNIMEVE 2024**

### **PLAN OBUKE 2024 - TRAINING PLAN 2024**



**Vushtrri, Qershor 2024**

| <b>TABELA E PËRMBAJTJES</b>  | <b>FAQE</b> |
|--|-------------|
| <b>Parathënia e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP</b>  | 3           |
| <b>Hyrje</b>   | 4           |
| <b>Akreditimi vendor dhe ndërkombëtar</b>  | 6           |
| <b>Qëllimi</b>   | 7           |
| <b>1. Trajnimet nga Policia e Kosovës</b>  | 8           |
| <b>1.1 Trajnimet nga fusha e Policisë së Përgjithshme</b>  | 9           |
| 1.1.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Përgjithsme e Policisë së Kosovës      | 10          |
| <b>1.2 Trajnimet nga fusha e Shkathtësive Operative</b>  | 11          |
| 1.2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Shkathtësive Operative                 | 12          |
| <b>1.3 Trajnimet nga fusha e Trafikut</b>  | 13          |
| 1.3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Trafikut                               | 14          |
| <b>1.4 Trajnimet nga fusha e Hetimeve</b>  | 15          |
| 1.4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Hetimeve                               | 16          |
| <b>1.5 Trajnimet nga fusha e Menaxhimit dhe Lidershipit</b>                                      | 17          |
| 1.5.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Menaxhimit dhe Lidershipit             | 18          |
| <b>1.6 Trajnimet nga fusha e Policisë Kufitare</b>   | 19          |
| 1.6.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Policisë Kufitare                      | 20          |
| <b>1.7 Trajnimet nga Fusha e Standardeve</b>   | 21          |
| 1.7.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Standardeve                            | 22          |
| <b>1.8 Trajnimet nga fusha e Njësive të Specializuara</b>  | 23          |
| 1.8.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Njësive të Specializuara               | 24          |
| <b>2. Trajnimet nga Agjencia për Menaxhim të Emergjencave</b>                                    | 25          |
| 2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga Agjencia për Menaxhim të Emergjencave            | 27          |
| <b>3. Trajnimet nga Inspektorati Policor i Kosovës</b>   | 28          |
| 3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga Inspektorati Policor i Kosovës                   | 29          |
| <b>4. Trajnimet nga Shërbimi Korrektues i Kosovës</b>  | 30          |
| 4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës                    | 31          |
| 4.2 Trajnimet të cilat do të realizohen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës në Q.T. Dubravë        | 32          |
| <b>5. Trajnimet nga Shërbimi Sprovues i Kosovës</b>  | 33          |
| 5.1 Trajnimet e Planifikuara për vitin 2024 nga Shërbimi Sprovues i Kosovës                      | 34          |
| <b>6. Trajnimet nga Dogana e Kosovës</b>   | 35          |
| 6.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga Dogana e Kosovës                                 | 37          |
| <b>7. Trajnimet nga Partnerët Ndërkombëtar</b>   | 38          |
| <b>7.1 Trajnimet nga OSBE</b>  | 39          |
| <b>7.2 Trajnimet e Njësiti Special Këshillues</b>  | 40          |
| 7.2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga Njësiti Special Këshillues                     | 41          |
| <b>7.3 Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi</b>   | 42          |
| 7.3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi  | 43          |
| <b>7.4 Sektori për Zhvillim të Policisë dhe Monitorim</b>  | 44          |
| 7.4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga Sektori për Zhvillim të Policisë dhe Monitorim | 45          |
| <b>8. Trajnimet e Përbashkëta</b>  | 46          |
| 8.1 Trajnimet e përbashkëta të planifikuara për vitin 2024                                       | 47          |
| <b>9. Përmbledhja e Planit të Trajnimit të AKSP për vitin 2024</b>                               | 48          |

## **PARATHËNIA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AKSP**

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit dhe arsimit të lartë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Akademia për një kohë të gjatë ofron dhe mban trajnime të vazhdueshme profesionale për zbatuesit e ligjit të punësuar në Institucionet e Sigurisë Publike siq janë:

- Policia e Kosovës;
- Shërbimi Korrektues i Kosovës;
- Shërbimi Sprovues i Kosovës;
- Dogana e Kosovës;
- Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave;
- Inspektorati Policor i Kosovës;

si dhe Institucionet tjera duke zhvilluar trajnime në fushën e sigurisë publike përfshirë bashkëpunimin me Partnerët Ndërkombëtarë ICITAP dhe OSBE.

Plani i Trajnimeve është rezultat i përbashkët i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike së bashku me Institucionet e Sigurisë Publike dhe Partnerët Ndërkombëtarë ( OSBE dhe ICITAP).

Plani i Trajnimeve publikohet në web-faqen e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe paraqet njërin prej dokumenteve më të rëndësishme të Akademisë e Kosovës për Siguri Publike.

Veçoria e këtij plani të publikuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike konsiston në faktin se paraqet planin e trajnimeve për Institucionet e Sigurisë Publike dhe Partnerëve Ndërkombëtarë.

**Kastriot Jashari**

**Zëvendësues Drejtor i Përgjithshëm i AKSP**

## **HYRJE**

*“Trajnimi dhe puna e përbashkët është frymëzuese”*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron trajnime dhe arsim të lartë për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës, Agjencinë për Menaxhim Emergjent, Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike zotohet të sigurojë cilësi të lartë profesionale gjatë trajnimeve në menaxhimin institucional, si dhe në shpërndarjen e burimeve për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike, gjithashtu është përgjegjëse për të siguruar standarde profesionale për arsimimin e të gjithë pjesëtarëve të Institucioneve të Sigurisë Publike.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka një histori unike dhe me qëllim të sqarimit sa më të thuket të saj e kemi ndarë në dy kategori të dallueshme:

➤ Zhvillimi institucional dhe zhvillimi edukativo-arsimor.

Kategoria e parë, zhvillimi institucional përfshin historinë e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike e cila ka kaluar nëpër tri faza: para vitit 1999, nga viti 1999-2006, dhe prej vitit 2006 e këtej.

Përfundimisht në vitin 2008 Akademia e Kosovës për Siguri Publike u bë agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, një qendër e arsimit dhe trajnimit për Institucionet e Sigurisë Publike të Kosovës.

Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve përmes trajnimeve dhe kurseve profesionale, si dhe forcimi i bashkëpunimit me ICITAP, OSBE dhe institucionet e tjera ndërkombëtare, është bërë me

qëllim të avancimit të mëtejshëm profesional, prandaj ato do të jenë edhe prioritet i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike gjatë viteve në vijim.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka për qëllim krijimin e një sigurie përmes fushës së arsimimit dhe bashkëpunimeve me institucionet e ngjashme në rajon dhe më gjerë, për të shkëmbyer përvojat dhe për të zhvilluar rrjetin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

## **AKREDITIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR**

### **Akreditimi vendor**

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në harmoni me legjislacionin në fuqi ka riakredituar Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si institucion i akredituar për Aftësim, Arsim Profesional për periudhën tre vjeçare përkatësisht nga data 27.07.2021 deri me datë 23.07.2024 me këto kualifikime:

- Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës;
- Zjarrfikës;
- Zyrtar Doganor;
- Zyrtar Korrektues;
- Zyrtar Policor;
- Zyrtar Sprovues;

### **Akreditimi ndërkombëtar**

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) është ri akredituar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit (IADLEST) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në fushën institucionale me çmimin më të lartë të ofruar ndonjëherë nga ky asociacion, Çmimin e Ekselencës, e vlefshme deri me datë 20.10.2024, dhe e radhitë AKSP të dytën në botë pas ShBA, që njëherësh është treguesi parësor i përmbushjes së misionit të AKSP si një Qendër e Ekselencës në rajon e më gjerë.

## QËLLIMI

Qëllimi i këtij plani të trajnimeve është planifikimi, organizimi dhe implementimi i analizës së nevojave të trajnimeve për Institucionet e Sigurisë Publike në fushën e ngritjes dhe avancimit të zyrtarëve të saj përmes trajnimeve të ndryshme.

Plani i trajnimit është një dokument unik i përfshirjes së të gjitha trajnimeve të planifikuara në baza vjetore përmes së cilët arrihet një pasqyrë mbi fushat e trajnimit, kohëzgjatjen e trajnimit, grupet e synuara dhe hapësirat e zhvillimit të trajnimit.

Plani i Trajnimit është dokument i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, i cili hartohet në bashkëpunim me Institucionet e Sigurisë Publike dhe Partnerët Ndërkombëtarë, që përmbush nevojat e adresuara për pjesëmarrje në trajnimet e parapara dhe të planifikuara bazuar në interesat e Institucioneve përkatëse të sigurisë publike.

Plani i trajnimeve paraqet koordinimin dhe bashkëpunimin në mes të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Institucioneve të Sigurisë Publike dhe Partnerëve Ndërkombëtarë në fushën e trajnimeve, përmes së cilit rritet efikasiteti dhe efektiviteti i zyrtarëve të sigurisë publike në përditshmërinë e zbatimit të detyrave zyrtare.

Zhvillimi i trajnimeve të Institucioneve të Sigurisë Publike në një institucion të vetëm, siç është Akademia e Kosovës për Siguri Publike, mbi të gjitha rezulton me koordinimin e mirëfilltë dhe racional të shërbimeve profesionale dhe mbështetëse të cilat i ofron Akademia e Kosovës për Siguri Publike për Institucionet e Sigurisë Publike.



# POLICIA E KOSOVËS



## 1. TRAJNIMET NGA POLICIA E KOSOVËS

Trajnimet nga Policia e Kosovës përbejnë një grup trajnimesh që ofrojnë njohuri bazike, të avancuara dhe të specializuara në fusha të ndryshme të performancës së zyrtarit policor me një gamë të gjërë trajnimesh nga ajo e përgjithshme e gjerë tek fusha e specializuar.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do fitojnë njohuri themelore të zyrtarit policor, legjislacionit, përdorimin dhe manovrimin e armëve të zjarrit, shkathtësive operative, menaxhmentit, trafikut, standardeve, fushën e policisë kufitare, fushën e hetimeve si dhe të njësive të specializuara.

Në përgjithësi vijuesitë e trajnimeve do të fitojnë aftësi dhe njohuri procedurat e ndryshme që ndërlidhen me punën dhe detyrat e zyrtarit policor në të gjitha dikasteret gjegjëse aktuale të Policisë së Kosovës.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do mund të trajnohen në këto fusha:

- 1.1 Fusha e Përgjithshme;
- 1.2 Fusha e Shkathtësive Operative;
- 1.3 Fusha e Trafikut;
- 1.4 Fusha e Hetimeve;
- 1.5 Fusha Menaxhment dhe Lidërsip;
- 1.6 Fusha e Policisë Kufitare;
- 1.7 Fusha e Standardeve;
- 1.8 Fusha e Njësive të Specializuara;



## **1.1 TRAJNIMET NGA FUSHA E POLICISË SË PËRGJITHSHME**

Trajnimet në fushën e përgjithshme përbejnë një grup trajnimesh, ku do të njihen me anën teorike dhe praktike si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë e profesionit policor.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Trajnimi për Zyrtar Policor;

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Kadetët Policor;

### 1.1.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Përgjithshme e Policisë së Kosovës

| Nr. | Emri i Trajnimit            | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnimit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        |         | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |
|-----|-----------------------------|-------------------------|--|---|-------------------|--|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|--|---------------------------------|
|     |                             |                         |  |   |                   | Janar                                      | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |  |                                 |
| 1   | Trajnimi për Zyrtar Policor | 12 javë                 | 1  | 450   | /                 | Gjatë vitit                                |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |

## **1.2 TRAJNIMET NGA FUSHA E SHKATHTËSIVE OPERATIVE**

Trajnimet në fushën e shkathtësive operative përbëjnë një grup trajnimesh të cilat janë kryesisht të fokusuara në fitimin e njohurive mbi taktikat mbrojtëse dhe të ndihmës së parë.

Në kuadër të këtij grupi ofrohen trajnimet mbi ndihmën e parë duke ofruar mundësinë e avancimit të pjesëmarrësve në Instruktur të ndihmës së parë, pastaj në trajnimin e instruktoreve të rinjë në fushën e mbrojtjes taktike.

Të gjithë vijuesitë të cilët i nënshtrohen trajnimeve nga ky grup i trajnimeve do jenë në gjendje të përcjellin njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga instruktorët tek zyrtarët tjerë në regjione në ngritjen e nivelit profesional dhe në kryerjen e detyrave të tyre në zonën e përgjegjësisë ku punojnë dhe veprojnë.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Trajnimi për Ndhimën e Parë;
- Trajnim për Trajner të Ndhimës së Parë;
- Trajnimi për Trajner të Taktikave Mbrojtëse;

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

### 1.2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Shkathtësive Operative

| Nr. | Emri i Trajnimit                            | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnimit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |       |       |     |         |        |       |         |       |        |         | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |
|-----|---|-------------------------|--|---|-------------------|--|--------|-------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|--|---------------------------------|
|     |   |                         |  |   |                   | Janar                                      | Shkurt | Mars  | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |  |                                 |
| 2   | Trajnimi për Ndhimën e Parë                 | 2 javë                  | 1  | 20  | A                 |  | 05-16  |       |       |     |         |        |       |         |       |        |         | SHKK   | AKSP                            |
| 3   | Trajnim për Trajner të Ndhimës së Parë      | 2 javë                  | 1  | 20  | I                 |  |        | 04-15 |       |     |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 4   | Trajnimi për Trajner të Taktikave Mbrojtëse | 12 javë                 | 1  | 20  | I                 |  |        |       | 01    |     |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |

### **1.3 TRAJNIMET NGA FUSHA E TRAFIKUT**

Trajnimet në fushën e trafikut përbëhen nga një grup trajnimesh të cilat përveç njohjes me elementet bazë të rregullave në trafik, ofrojnë mundësinë e ngritjes profesionale në menaxhimin e trafikut dhe hetimet e aksidenteve, pastaj analizën e aksidenteve të komunikacionit rrugorë si dhe gjatë vozitjes së veturave në raste emergjente.

Vijuesitë të cilët i nënshtrohen këtyre trajnimeve do kenë mundësinë që përkrah pjesës teorike të zhvillojnë edhe anën praktike e cila do aplikohen në terren/poligonet e AKSP si dhe në rrugë të hapura gjatë trajnimeve gjegjëse.

#### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Menaxhimi i Trafikut dhe Hetimi i Aksidenteve;
- Trajnimi për Analizën e Aksidenteve të Komunikacionit Rrugor;
- Trajnimi Ngasja Emergjente;

#### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

### 1.3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Trafikut

| Nr. | Emri i Trajnitimit   | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnitimit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |       |       |     |         |        |       |         |       |        | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |         |
|-----|--|-------------------------|--|---|---------------------|--|--------|-------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|--|---------------------------------|---------|
|     |  |                         |  |   |                     | Janar                                      | Shkurt | Mars  | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor |  |                                 | Dhjetor |
| 5   | Menaxhimi i Trafikut dhe Hetimi i Aksidenteve                | 4 javë                  | 1  | 20  | A                   |  |        | 04-29 |       |     |         |        |       |         |       |        |  |                                 | AKSP    |
| 6   | Trajnimi për Analizën e Aksidenteve të Komunikacionit Rrugor | 4 javë                  | 1  | 20  | A                   |  |        |       | 01-26 |     |         |        |       |         |       |        |  |                                 | AKSP    |
| 7   | Trajnimi Ngasja Emergjente                                   | 1 javë                  | 1  | 20  | A                   | 22-26                                      |        |       |       |     |         |        |       |         |       |        |  | AME, SHKK                       | AKSP    |

## **1.4 TRAJNIMET NGA FUSHA E HETIMEVE**

Trajnimet në fushën e hetimeve, janë trajnime të nivelit bazik, të avancuar dhe të specializuar përmes së cilave vijuesitë do arrijnë nivelin e duhur profesional në këtë fushë për të performuar detyrat në vendin e punës.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do kenë mundësinë që përveç trajnimit themelor të hetimit të krimit, të fitojnë njohuri edhe në trajnimin e hetimit të zjarrit dhe zjarrvënies, dhunës në familje, metodat e ndryshme të nxitjes së gjurmëve latente me kemikale si dhe krimtechnikët e vendit të ngjarjes.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Trajnim Themelor i Hetimeve të Krimit;
- Trajnimi Hetimi i Zjarrit dhe Zjarrvënia;
- Trajnimi për Hetimin e Dhunës në Familje;
- Trajnimi për Nxitjen e Gjurmëve Latente me Kemikale;
- Trajnimi Krimtechnikët e Vendit të Ngjarjes;

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

### 1.4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Hetimeve

| Nr. | Emri i Trajnimit                                    | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnimit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |      |       |       |         |        |       |         |       |        |         | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |
|-----|---|-------------------------|--|---|-------------------|--|--------|------|-------|-------|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|--|---------------------------------|
|     |   |                         |  |   |                   | Janar                                      | Shkurt | Mars | Prill | Maj   | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |  |                                 |
| 8   | Trajnim Themelor i Hetimeve të Krimin               | 4 javë                  | 1  | 20  | B                 | 15   |        |      |       |       |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 9   | Trajnimi Hetimi i Zjarrit dhe Zjarrvënia            | 1 javë                  | 1  | 20  | S                 |  |        |      | 01-05 |       |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 10  | Trajnimi për Hetimin e Dhunës në Familje            | 1 javë                  | 1  | 20  | A                 |  | 26     |      |       |       |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 11  | Trajnimi për Nxitjen e Gjurmëve Latente me Kemikale | 1 javë                  | 1  | 20  | /                 |  |        |      |       | 13-17 |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 12  | Trajnimi Krimteknikët e Vëndit të Ngjarjes          | 6 javë                  | 1  | 20  | A                 |  |        |      |       |       | 03      |        |       |         |       |        |         |  |                                 |



## **1.5 TRAJNIMET NGA FUSHA E MENAXHIMIT DHE LIDERSHIPIT**

Trajnimet në fushën e menaxhimit dhe lidërsnipit përbejnë një grup trajnimet të niveleve të ndryshme menaxheriale të cilat ofrojnë mundësinë e përgatitjes së menaxherëve të rinjë si dhe menaxherëve ekzistues në ballafaqimin dhe menaxhimin e sfidave të ndryshme në punën e përditshme në vendimmarrje, planifikim, si dhe organizim brenda organizatave ku ata veprojnë.

Trajnimet në këtë fushë janë të një rëndësie të lartë meqë ofrojnë njohuri për liderët e ardhshëm me anë të aplikimit të formave të reja bashkohore të bashkëpunimit, komunikimit, motivimit dhe planifikimit strategjik në planet e veprimit.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Menaxhimi i Vijës së Parë (Reshter);

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

### 1.5.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Menaxhimit dhe Lidershipit

| Nr. | Emri i Trajnimit                    | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnimit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        |         | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |
|-----|-------------------------------------|-------------------------|--|---|-------------------|--|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|--|---------------------------------|
|     |                                     |                         |  |   |                   | Janar                                      | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |  |                                 |
| 13  | Menaxhimi i Vijës së Parë (Reshter) | 5 javë                  | 1  | 20  | B                 | Gjatë vitit                                |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        |         | AME  | AKSP                            |

## **1.6 TRAJNIMET NGA FUSHA E POLICISË KUFITARE**

Trajnimet në fushën e policisë kufitare janë trajnime të cilat ndërlidhen me detyrat e zyrtarëve policor kufitar dhe si të tilla përveç që ofrojnë njohuri bazike dhe të avancuara mbi punën e zyrtarëve dhe policisë kufitare si dhe mbikëqyrjen kufitare.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Trajnimi i Avancuar për Mbikëqyrjen e Kufirit;
- Trajnimi Bazik i Policisë Kufitare - Frontex;

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

### 1.6.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Policisë Kufitare

| Nr. | Emri i Trajnimit                              | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnimit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |         |
|-----|---|-------------------------|--|---|-------------------|--|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|--|---------------------------------|---------|
|     |   |                         |  |   |                   | Janar                                      | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor |  |                                 | Dhjetor |
| 14  | Trajnimi i Avancuar për Mbikëqyrjen e Kufirit | 2 javë                  | 1  | 20  | A                 |  |        |      |       |     | 03-14   |        |       |         |       |        |  |                                 | AKSP    |
| 15  | Trajnimi Bazik i Policisë Kufitare - Frontex  | 4 javë                  | 1  | 20  | B                 |  | 26     |      |       |     |         |        |       |         |       |        |  |                                 | AKSP    |

## **1.7 TRAJNIMET NGA FUSHA E STANDARDEVE**

Në fushën e standardeve, zyrtarët e sigurisë publike do trajnohen për aftësimin e instruktorëve të ardhshëm dhe do të fitojnë shkathhtësitë e të qenurit instruktor ligjërues meqë përkrah anës teorike do zhvillohet edhe ajo praktike për përgatitjen e instruktorëve të rinj.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh pjesëmarrësit do kenë mundësinë të trajnohen në:

- Programi për Aftësimin e Instruktorëve;

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

### 1.7.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Standardeve

| Nr. | Emri i Trajnimit                       | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnimit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |       |       |     |         |        |       |         |       | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |        |
|-----|--|-------------------------|--|---|-------------------|--|--------|-------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--|---------------------------------|--------|
|     |  |                         |  |   |                   | Janar                                      | Shkurt | Mars  | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor |  |                                 | Nëntor |
| 16  | Programi për Aftësimin e Instruktorëve | 4 javë                  | 1  | 20  | I                 |  |        | 04-29 |       |     |         |        |       |         |       |  | AME, SHKK                       | AKSP   |

## **1.8 TRAJNIMET NGA FUSHA E NJËSIVE TË SPECIALIZUARA**

Trajnimet nga fusha e njësive të specializuara përbëjnë nja grup të trajnimeve intensive.

Vijuesitë e këtyre trajnimeve do të njihen me shkathtësitë dhe aftësitë për intervenim, arrestim, bastisje dhe përcjellje në situata me rrezikshmëri të lartë si dhe do të përfitojnë njohuri për mbrojtjen e personave të rëndësishëm.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Trajnim për NJSI;
- Trajnim për Mbrojtje të Afërt;

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

### 1.8.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga fusha e Njësive të Specializuara

| Nr. | Emri i Trajnimit              | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnimit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |
|-----|-------------------------------|-------------------------|--|---|-------------------|--|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|--|---------------------------------|
|     |                               |                         |  |   |                   | Janar                                      | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor |  |                                 |
| 17  | Trajnim për NJSI              | 12 javë                 | 1  | 20  | B                 | Gjatë vitit                                |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        |  | AKSP                            |
| 18  | Trajnim për Mbrojtje të Afërt | 12 javë                 | 1  | 20  | A                 | Gjatë vitit                                |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        |  | AKSP                            |





# AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE



## 2. TRAJNIMET NGA AGJENCIA PËR MENAXHIM TË EMERGJENCAVE

Trajnimet në fushën e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave përbejnë një grup trajnimesh të cilat ofrojnë njohuri bazike, të avancuara dhe të specializuara.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do fitojnë njohuri rreth përdorimit të mjeteve themelore gjatë shuarjes së zjarreve, bazat e menaxhimit emergjent, vlerësimin e rreziqeve, zvogëlimin e rreziqeve, reagimi në aksidentet e komunikacionit rrugor, do të kuptojnë rolin e sistemit të integruar të menaxhimit emergjent, vlerësimin e dëmëve, përdorimin e paisjeve zjarrfikëse si dhe shpëtim si dhe planin e reagimit kombëtar.

Ndërsa në Trajnimin Profesional për Zjarrfikës, kadetët do të njihen me anën teorike, praktike si dhe me detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilit janë kryerja e punëve të zjarrfikjes dhe shpëtimit.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Përdorimi i Mjeteve Themelore Gjatë Shuarjes së Zjarreve;
- Trajnimi Profesional Zjarrfikës;
- Bazat e Menaxhimit Emergjent;
- Vlerësimi i Rreziqeve;
- Zvogëlimi i Rreziqeve;
- Aksidentet e Komunikacionit Rrugor;
- Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent;
- Vlerësimi i Dëmëve;
- Trajnimi Bazik në Zjarrfikje dhe Shpëtim;
- Plani i Reagimit Kombëtar;

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtarët nga Njësia Profesionale në Zjarrfikje dhe Shpëtim;
- Zyrtarët e drejtorive në nivel lokal dhe planifikuesit në nivel qendror;

- Zyrtarët për Planifikim dhe Parandalim të Fatkeqësive;
- Ministrinë, Agjencitë, Sektori Privat dhe OJQ-të;
- Insitucionet tjera;
- Vullnetar;

## 2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2024 nga Agjencia për Menaxhim të Emergjencave

| Nr. | Emri i Trajnit   | Kohëzgjatja e trajnimit | Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit | Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit | Lloji i Trajnit | PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT |        |       |       |       |         |        |       |         |       |        |         | Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit | Vendi i realizimit të trajnimit |
|-----|--|-------------------------|--|---|-----------------|--|--------|-------|-------|-------|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|--|---------------------------------|
|     |  |                         |  |   |                 | Janar                                      | Shkurt | Mars  | Prill | Maj   | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |  |                                 |
| 1   | Përdorimi i Mjeteve Themelore gjatë Shuarjes së Zjarreve | 3 ditë                  | 1  | 22  | B               |  | 06-08  |       |       |       |         |        |       |         |       |        |         | SHKK   | AKSP                            |
| 2   | Trajnimi Profesional Zjarrfikës                          | 3 muaj                  | 1  | 22  | P               |  | 10     |       |       |       |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 3   | Bazat e Menaxhimit Emergjent                             | 5 ditë                  | 1  | 20  | B               |  |        | 04-08 |       |       |         |        |       |         |       |        |         | SHKK   | AKSP                            |
| 4   | Vlerësimi i Rreziqeve                                    | 3 ditë                  | 1  | 20  | B               |  |        |       | 03-05 |       |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 5   | Zvogëlimi i Rreziqeve                                    | 2 ditë                  | 1  | 20  | B               |  |        |       | 11-12 |       |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 6   | Trajnimi Aksidentet e Komunikacionit Rrugor              | 1 javë                  | 1  | 22  | B               |  |        |       |       | 03-07 |         |        |       |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 7   | Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent               | 5 ditë                  | 1  | 20  | B               |  |        |       |       |       |         |        | 09-13 |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 8   | Vlerësimi i Dëmëve                                       | 5 ditë                  | 1  | 20  | /               |  |        |       |       |       |         |        | 23-27 |         |       |        |         |  | AKSP                            |
| 9   | Trajnimi Bazik në Zjarrfikje dhe Shpëtim                 | 2 javë                  | 1  | 22  | B               |  |        |       |       |       |         |        |       | 07-18   |       |        |         | SHKK   | AKSP                            |
| 10  | Plani i Reagimit Kombëtar                                | 5 ditë                  | 1  | 20  | /               |  |        |       |       |       |         |        |       |         | 11-15 |        |         |  | AKSP                            |



# INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS



## 3. TRAJNIMET NGA INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Trajnimet janë dizajnuar në bazë të kërkesave që dalin nga detyrat e zyrtarëve të Inspektoratit Policor të Kosovës, me anë të të cilave vijuesitë në trajnime do të fitojnë shkathtësitë e nevojshme profesionale gjithnjë duke respektuar aktet normative të Republikës së Kosovës gjatë kryerjes së detyrave zyrtare si dhe gjithashtu pregaditjen e profesionistëve të sigurisë për të kuptuar dhe trajtuar sfidat etike që ata mund të hasin në punën e tyre, duke përfshirë edhe hetimet kibernetike, pastaj profilizimin e hetuesve të IPK për trajtimin e rasteve të trafikimit si dhe përdorimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve teknike dhe teknologjike në proceset hetimore.

### **TRAJNIMET:**

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen në:

- Kursi i Ricertifikimit;
- Dilemat Etike në Vendimmarrje për Institucionet e Sigurisë;
- Hetimet Kibernetike dhe Shfrytëzimi i Internetit për Verifikime Specifike Orientuese;
- Profilizimi i Hetuesve të Inspektoratit Policor për Trajtimin e Rasteve të Trafikimit;
- Përdorimi dhe Shfrytëzimi i Pajisjeve Teknike/Teknologjike në Proceset Hetimore;

### **GRUPET E SYNUARA:**

- Zyrtar të Inspektoratit Policor të Kosovës;
- Zyrtar të Institucioneve të Sigurisë Publike;

